

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më 28/05/2026

**LËNDA: PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – MALLRA MBI KUFIRIN E
LARTË MONETAR**

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM NË GJUHËN SHQIPE DHE ANGLEZE**

I mbajtur sot në datë 28.05.2026 nga anëtarët e Njësisë së Prokurimit, Z. Aleksandër Pjetri, person përgjegjës, të emëruar sipas Urdhërit të Prokurimit Nr. 519/3 Prot, datë 28.05.2026 për procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje DGA + BMT”.

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP): Transformatorë tensioni 31172000-2; Pajisje elektrike 31681000-3; Panele të tensionit të mesëm 31682300-3; Panele kontrolli 31211110-2; Panele 44175000-7.

Vlera e fondit limit: 49,900,000.00 (Dyzet e nëntë milionë e nëntëqindë mijë) lekë pa TVSH ose 521,203.26 (pesëqind e njëzet e një mijë e dyqind e tre presje njëzet e gjashtë) Euro, sipas kursit të këmbimit 1 Euro = 95.74 lekë.) euro pa TVSH. Kursi këmbimit sipas Bankës së Shqiperisë i datës 28.05.2026 është 95.74 (nëntëdhjetë e pesë pikë shtatëdhjetë e katër).

Afati i lëvrimin: 4 (katër) muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Baza ligjore për zhvillimin e kësaj procedure

Zhvillimi i kësaj procedure të prokurimit mbështetet në dispozitat ligjore dhe nënligjore në fuqi, si më poshtë:

- Neni 33, pika 1, shkronja “a”, e Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, i cili përcakton se autoritetet kontraktore përdorin procedurën e hapur për blerjen e mallrave, shërbimeve ose punëve mbi kufirin e lartë monetar.
- Neni 40 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, i cili rregullon mënyrën e zhvillimit të procedurave të hapura mbi kufirin e lartë monetar për mallra, duke garantuar transparencë, konkurrencë dhe zbatim të drejtë të parimeve të ligjit.
- Neni 3 i Ligjit nr. 162/2020, që përcakton parimet bazë të prokurimit publik, si transparenca, trajtimi i barabartë i operatorëve ekonomikë, mosdiskriminimi dhe përdorimi efikas i fondeve publike.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Për argumentimin e fondit limit grupi i punes i caktuar me urdher te titullarit te Ak-se, j'u referuan studimit të tregut, në mbështetje të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

Në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon:

- a) çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe
- b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim; ose/dhe
- c) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe
- ç) çmimet ndërkombëtare të shpallura publikisht.

Autoriteti/enti kontraktor mund t'i referohet një ose me shumë alternativave të mësipërme në përlogaritjen e vlerës limit të kontratës, me qëllim që ajo të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë.

2. Autoriteti/enti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të argumentojë dhe të dokumentojë përlogaritjen e vlerës së kontratës, bazuar në specifikimet teknike të objektit që prokurohet.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor ka shqyrtuar mundësinë e ndarjes së kësaj procedure prokurimi në lote dhe ka arritur në përfundimin se ndarja në lote nuk është e përshtatshme për këtë objekt.

Objekti i prokurimit “DG dhe BMT – BLERJE” përbën një furnizim të unifikuar dhe funksionalisht të lidhur, ku elementët përbërës janë teknikisht të ndërvarur dhe të domosdoshëm për realizimin e një sistemi të vetëm funksional. Ndarja në lote do të cenonte integritetin teknik të furnizimit dhe do të rrezikonte përputhshmërinë midis komponentëve.

Mosndarja në lote justifikohet mbi bazën e këtyre arsyeve kryesore:

1. **Uniteti teknik dhe funksional i objektit të prokurimit**
Mallrat e kërkuara janë pjesë përbërëse e një sistemi të vetëm dhe kërkojnë përputhshmëri të plotë teknike. Ndarja në lote do të krijonte rrezik të mosndërveprimit dhe mosfunksionimit të sistemit.
2. **Sigurimi i përgjegjësisë së vetme kontraktore**
Kontrata e unifikuar garanton një përgjegjësi të vetme për cilësinë, përputhshmërinë

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

dhe funksionimin e plotë të furnizimit, duke shmangur paqartësitë në ndarjen e përgjegjësi ndërmjet operatorëve ekonomikë të ndryshëm.

3. **Menaxhimi më efikas i kontratës dhe ulja e riskut administrativ**

Ndarja në lote do të rrisë kompleksitetin e menaxhimit kontraktor, koordinimin midis furnitorëve dhe rrezikun e vonësive në zbatim.

4. **Rreziku i moskoordinimit në afate dhe implementim**

Furnizimi dhe dorëzimi i komponentëve nga operatorë të ndryshëm do të krijonte risk të mospërputhjes së afateve dhe integritimit teknik.

5. **Efikasitet ekonomik dhe praktik i tregut**

Duke marrë parasysh natyrën e tregut, këto produkte zakonisht ofrohen si zgjidhje të integruara nga operatorë të specializuar, duke e bërë ndarjen në lote jo eficiente dhe jo ekonomike.

Në përfundim, autoriteti kontraktor vlerëson se ndarja në lote nuk do të ishte në përputhje me parimet e eficiencës, efektivitetit dhe menaxhimit të mirë të fondeve publike, dhe për rrjedhojë procedura zhvillohet si një lot i vetëm.

Në këto kushte, mosndarja në lote është e arsyetuar dhe në përputhje me nenin 39 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 2 parashikohet shprehimisht se: “*Qëllimi i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, prashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A **DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njeh gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik. Në rastin konkret, ndarja në lote e procedurës së prokurimit, do të komplikonte menaxhimin e minikontratave dhe shpërndarjen e përgjegjësisë duke e komplikuar realizimin me sukses të kontratës.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, neni 2, pika 2/c dhe neni 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor, **Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH sh.a**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim si dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

2.2.1 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023, 2024,2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e kërkuar është në përpjestim të drejtë me fondin limit të procedurës.

Kërkesat e mësipërme i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjëndjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të viteve: (2023, 2024,2025) të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese.

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar ku përcaktohet

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

se: “Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”, si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.”, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2026, ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar sipas ligjit nr.9632 datë 30.10.2006”Për sistemin e taksave vendore”i ndryshuar; (lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njesite e veteqeverisjes vendore për vitin 2026), në të cilën është regjistruar sipas QKB dhe vendimeve të Këshilleve Bashkiake të njëjësive vendore ku operatorët ushtrojnë aktivitetin.

(Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë se ka paguar detyrimet e taksave vendore për vitin 2026 sipas ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të DST-së objekt prokurimi.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Shënim: Ndërsa operatori ekonomik i kualifikuar i pari, duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 40% e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kriteri i mësipërm është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % e vlerës limit të kontratës që prokurohet, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatorët ekonomikë ofertues duhet të plotësojnë dhe të dorëzojnë së bashku me dokumentet e tjera, skedën teknike për artikujt me emërtesën e artikullit në të cilën duhet të deklarohen të dhënat e kërkuara, sipas tabelës së mëposhtme:

Tabelat e të dhënave teknike të pajisjeve të kërkuara dhe ato të ofruar nga operatorët ekonomik.

1. Sistem unik i integruar DGA dhe BMT për transformatore fuqie.

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

| DTL / OSSH | | | |
|--|-------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|
| 1. Sistem unik i integruar DGA dhe BMT per transformatore fuqie | | | |
| Te dhenat teknike te kerkuar dhe ofertuara per DGA. | | | |
| Nr | Pershkrimi | Te dhenat teknike te kerkuara | Te dhenat teknike te ofruara |
| 1 | Prodhuesi | | |
| 2 | Vendi prodhimit | | |

| Nr. | Përshkrimi i sistemit | Sasia e kerkuar | Sasia e ofruar |
|------------|---|------------------------|-----------------------|
| 1. | Sistem unik i integruar monitorimi online DGA (Diagnostikim, Analizim i Gazrave) te ciluar ne vajin e transformatorit te fuqise dhe BMT (Monitorim Izolacioni ne Bushing) monitorim i gjendjes se izolacionit te izolatoreve kalimtare 110 kV dhe nivelit te shkarkimeve pjesore (partial discharge PD) brenda kazanit te transformatorit te fuqise ne N.Stacion, te kompletuara me aksesoret e montimit e sensoret e instalimit, sipas specifikimeve. (komplet set). | 2 | |
| 2. | Desktop PC workstation profesional per instalimin dhe konfigurimin ne sallën e komandes ne N.Stacion, te sistemit lokal me baze server PC per monitorimin on-line DGA & BMT, sipas specifikimeve (cope). | 1 | |

**OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A
DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË**

| | | | |
|----|--|----|--|
| | | | |
| 3. | Rrjet komunikimi Ethernet kabëll Fibër Optike, kompletuar me LAN Switch, konektorët e fibrës optike dhe konvertitorin Ethernet RJ45 –Fibër instaluar në brëndësi të setit on-line AGT, në kablllo të armuar me fibër optike sipas kërkesave teknike përkatëse, nga transformatorët e fuqisë në shfrytëzim deri në sallën e komandës përkatëse. (komplet set) | 1 | |
| 4. | Instalimi dhe komisionimi i sistemit monitorimi online DGA & BMT, në transformatorët e fuqisë i setit të pajisjes të monitorimit on-line DGA & BMT, sipas specifikimeve teknike ne transformatore e fuqise te kerkuar. (komplet set) | 1 | |
| 5. | Pajisja do te komisionohet, testohet dhe vendoset ne pune ne transformatore fuqise, ku eshte objekti i ketij furnzimi. | po | |

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të: Nenit 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i cili përcakton se autoriteti kontraktor duhet të përshkruajë me saktësi objektin e kontratës dhe karakteristikat teknike të mallrave kryesore që prokurohen, duke përdorur standarde dhe referenca objektive që sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe vlerësim transparent të ofertave;

Neni 40, pika 6, gërma (c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku sanksionohet se autoritetet kontraktore kanë të drejtë të kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentacion mbështetës që provon përputhshmërinë

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

teknike të mallrave të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë certifikata të lëshuara nga institucione të njohura apo deklarata konformiteti.

2.3.3 Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të provojnë që janë të autorizuar nga prodhuesi i deklaruar i pajisjeve që ofrojnë (sipas deklarimit në skedën teknike) ose nga distributorët e autorizuar nga prodhuesi për realizimin e furnizimeve me artikujt objekt kontrate. Në rast se do të paraqitet autorizim nga distributorë të autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja midis Distributorit të Autorizuar dhe Prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Autorizim prodhuesi duhet te jete per pajisjen e meposhtme:

Sistem unik i integruar DGA & BMT.

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e autorizimeve të prodhuesve ose distributorëve se operatorët ekonomikë janë të autorizuar nga prodhuesi apo distributori i autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përvecse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteri i mësipërm është në përputhje me nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2.3.4 Operatori Ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/ët teknik te prodhuesit për mallrat që do të furnizojë për këtë objekt prokurimi, perfshire edhe skeden teknike, në mënyrë që të provohet pajtueshmeria me specifikimet teknike per pajisjet e mesiperme. *Në katalog, të markohen në menyrë të qartë dhe të dallueshme mallrat e ofertuara, si edhe specifikimet përkatëse sipas të dhënave në DT. Katalogu të përmbajë karakteristikat teknike, me qëllim që AK të vlerësojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në DT.*

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e katalogut/ëve është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar, si dhe për të verifikuar përmbushjen e specifikimeve teknike të mallrave objekt prokurimi.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deshmi të testimeve zyrtare të kryera për mallrat e specifikuar më lart në skeden teknike, objekt prokurimi të leshuara nga institucione të autorizuara nga prodhuesi ose ekuivalentet e tyre, që vertetojnë pajtueshmërinë e mallrave të prodhuara sipas specifikimeve teknike dhe standartet e kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kriteret e kualifikimit vendosen që ti shërbejnë AK-se, për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të OE-ve, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vertetojnë se zoterojnë kualifikimet e nevojshme si aftësi organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe çdo element tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në përmbushje të kriterit të mesipër, Operatorët Ekonomikë, duhet të paraqesin deshmi të testimeve zyrtare të kryera, leshuar nga institucione të autorizuara, ose nga prodhuesi, për mallrat e cituar më sipër, për të krijuar bindjen se malli i ofruar është brenda parametrave të kërkuara. Është në të drejtën e AK të kërkojë deshmi për rezultatet e testimeve zyrtare që vertetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike të vendosura, përpara se AK të bëjë përzgjedhjen e OE-se fituese. Kjo kërkesë është në përputhje me pikën 6/c, të nenit 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

a) Certifikatën e cilësisë së punimeve SSH EN UNI ISO 9001-2015 e perditesuar (e vlefshme)/ose/ekuivalent. Certifikata të jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo certifikate kerkohet ne momentin e levrimit te mallit nga operatori ekonomik fitues dhe shoqeron mallin qe instalohet ne objekt. Kurse ne momentin e ofertimit, AK pranon mundësinë të një vetëdeklarimi nga OE ofertues që në këtë rast, furnizuesi është konform standardeve të cilësisë dhe rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 2.3.6 janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 79, pika 1 ku citohet se: “Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”, si dhe ne zbatim te Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të leshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, qe i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë deklaratë konformiteti ku të shprehet që materialet të kenë markim *CE/SSH IEC SSH EN* /ose ekuivalentet e tyre.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur në zbatim të: Nenit 77, pika 1, të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i cili përcakton se autoriteti kontraktor duhet të përshkruajë me saktësi objektin e kontratës dhe karakteristikat teknike të mallrave që prokurohen, duke përdorur standarde dhe referenca objektive që sigurojnë konkurrencë të ndershme dhe vlerësim transparent të ofertave;

Neni 40, pika 6, gërma (c), të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku sanksionohet se autoritetet kontraktore kanë të drejtë të kërkojnë që operatorët ekonomikë të paraqesin dokumentacion mbështetës që provon përputhshmërinë teknike të mallrave të ofruara me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, përfshirë certifikata të lëshuara nga institucione të njohura apo deklaratë konformiteti.

Kërkesa për paraqitjen e deklaratës së konformitetit ka për qëllim të garantojë se materialet e ofruara janë të certifikuara dhe në përputhje me standardet e sigurisë dhe cilësisë të njohura ndërkombëtarisht. Markimi **CE, SSH, IEC, EN** (ose ekuivalentët e tyre) vërteton se produktet janë prodhuar sipas kërkesave teknike dhe standardeve të aplikueshme, duke siguruar cilësi, siguri dhe ndërrveprueshmëri me pajisje të tjera në përdorim.

2.3.8 Lidhur me sistemin unik të integruar DGA & BMT, Operatorët ekonomikë në funksion të përmbushjes së detyrimeve të përcaktuara në specifikimet teknike/termat e referencës lidhur me instalimin, konfigurimin, programimin dhe zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë suportit 1 vjeçar si dhe trajnimin e personelit që do të përdorë sistemin e integruar unik me pajisjet DGA & BMT, duhet të dëshmojnë se kanë pjesë të stafit të shoqërisë ose me kontratë shërbimi 1 (një) specialist të kualifikuar/certifikuar nga prodhuesi i pajisjeve për sa më sipër, i cili të jetë i diplomuar në një nga fushat si: Inxhinieri Elektrike ose Elektronike.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Kontraten e punes
- Çertifikaten e trajnimit;
- Diplomën e inxhinierit;

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST.

Dokumentacioni si më sipër do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose në rast se do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të objektit të prokurimit dhe/ose komponentët e tij. Drejtoria e Tensionit të Lartë OSSH SH.A, duhet të ketë besueshmërinë dhe të kërkojë garanci për realizimin me sukses të kontratës objekt prokurimi, duke përfshirë kërkesat për një 1 (një) inxhinier elektrik ose elektronik i çertifikuar nga prodhuesi/ekuivalentet për sistemin unik të integruar DGA & BMT.

Sistemi unik i integruar me pajisjet DGA & BMT analizojnë gazrat e tretur dhe matjen e lagështisë në vajin e transformatoreve të fuqisë dhe monitorimin e izolacionit në izolateret kalimtare 110 kV dhe shkarkimet pjesore PD, dhe njihet si një test i rëndësishëm për vlerësimin e gjendjes së transformatorëve fuqisë, me izolacion të peshtjellave në vaj, si janë edhe transformatorët në N. Stacionet elektrike të Shpërndarjes.

Sistemi unik i integruar DGA & BMT ofron diagnostikim, analizim, të detajuara online për çlirimin e gazrave në vajin e transformatorit të fuqisë, monitorojnë izolacionin në izolateret kalimtar 110kV dhe rregjistrojnë dhe sinjalizojnë të dhenat teknike të monitoruara.

Ky sistem duhet të jetë i aftë për tu integruar me sistemin qendror të monitorimit për të dy proceset, në OSSH qendrore në mënyrë që të sinjalizojë gjendjen reale të transformatorit.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

- Gazrat e ciluar ne vajin e transformatoreve te fuqise dhe tap changer te tyre.
- Izolacioni i izolatoreve kalimtar 110kV ne transformaret e fuqise.

Teorikisht analizimi i gazrave te ciluar ne vajin e transformatorit te fuqise dhe monitorimi i izolacionit ne izolaret 110kV ndikojne realisht ne jetegjatesine e pajisjes me kryesore te N.Stacioneve elektrike si jane transformaret e fuqise.

Kjo pajisje kërkojne konfigurim, parametrizim dhe përshtatje software-i me të dhënat teknike të transformatorëve që do të monitorohen. Për këtë arsye, është e domosdoshme që operatori ekonomik të disponojë një inxhinier elektrik të certifikuar nga prodhuesi (ose ekuivalent), i cili ka njohuritë teknike për të:

- konfiguruar sistemin sipas specifikimeve të pajisjes dhe kërkesave të autoritetit kontraktor;
- programuar dhe përshtatur software-in e analizës online te gazrave me parametrat e funksionimit të transformatorëve ekzistues;
- verifikuar saktësinë e matjeve dhe analizave të gazrave, për të garantuar që pajisja do të japë rezultate të besueshme;
- programuar dhe përshtatur software-in e monitorimit online per izolacionin e izolatoreve kalimtar 110kV dhe shkarkimet e pjeshme ne ato.
- siguruar funksionimin e qëndrueshëm dhe të sigurt të sistemit në mjedisin e punës së autoritetit kontraktor;
- trajnim te specialisteve për përdorim dhe mirëmbajtje, në përputhje me udhëzimet e prodhuesit.

Ky veprim siguron që pajisja të funksionojë në mënyrë korrekte, të ofrojë matje dhe analiza të sakta, si dhe të garantojë përdorim të sigurt dhe jetëgjatësi të sistemit të monitorimit.

Prandaj, kërkesa për inxhinier elektrik të certifikuar nuk lidhet me një kontratë pune, por është një kërkesë teknike për të garantuar që furnizimi të shoqërohet me asistencën profesionale të nevojshme për vënien në punë dhe konfigurimin e saktë të pajisjes për nevoja operationale të autoritetit kontraktor.

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES SH.A DREJTORIA E TENSIONIT TË LARTË

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqese nje deklarate, ku deklaron se te gjithë produktet jane te rinj (te paperdorur).

